REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHERBIMEVE FINANCIARE DHE BUXHETIT
SEKTORI I PLANIFIKIMIT TE BUXHETIT

Nr 625/1 **Prot** **Bilisht më,** 17 / 02 /2026

Lënda: Dërgimi i raporteve të monitorimit për 12- mujorin e tretë 2025.

MINISTRISË SË FINANCAVE

DREJTORISË SË PERGJITHSHME TË BUXHETIT DHE BORXHIT PUBLIK

DREJTORISË SË FINANCAVE

Në kuadër të bashkëpunimit si dhe në zbatim të pikes 3, neni 48 i ligjit nr.68 datë 27.04.2021 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore "po ju dergojmë raportet e monitorimit për 12-mujorin e tretë 2025.

Duke ju uruar punë te mbarë!

Konceptoi: E.Bejolli

Pranoi: B. Diko

Miratoi: A. Furxhi

Konfirmoi: A.Rushitaj

KRYETARI I BASHKISË

Eduard Duro

Adresa:BashkiaDevoll,Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 9,Tel& Fax +355811123815-22288,e-mail bashkiadevoll@gmail.com.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E SHERBIMEVE FINANCIARE DHE BUXHETIT

SEKTORI I PLANIFIKIMIT TE BUXHETIT

Nr.625 prot. **Bilisht më 17.02.2026**

RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT TË VITIT 2025

Në mbështetje të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 48 "Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor", udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.22 datë 30.07.2018 "Për Proçedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", i paraqitim grupit për monitorimin e zbatimit të buxhetit për raportin e trete përfundimtar të Monitorimit të Buxhetit të Bashkisë Devoll për vitin 2025.

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit për Vitin 2025, është bërë në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si më poshtë:

- Ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", i ndryshuar.
- Ligji nr.115/2024 "Për Buxhetin e vitit 2025" I ndryshuar me aktet normative nr 03 date 29.04.2025, numer 06 datë 11.06.2025 dhe me aktin normative nr.10 datë 08.10.2025.
- Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar
- Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2 datë 06.02.2012 "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit"
- Ligjit nr.68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" I ndryshuar ne nenet 55, pika 1 dhe 2,56,pika 1,57 , pika 1,dhe 59 pika 1, fjalet "të shpenzimeve vjetore te miratuara "zvendesohen me fjalet "te shpenzimeve vjetore faktike ".
- Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë" i ndryshuar.
- - VKM nr. 503 datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në vendimin nr.328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave, për klasifikimin e funksioneve , grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore , për efekt page dhe caktimin e kufijeve të pagave, të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar të nënpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore".
- - VKM nr.438 datë 08.06.2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore dhe jopyjore.

- VKM nr.1064 datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime të vendimit të këshillit të ministrave nr.391 datë 21.06.2006 për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave".
- Udhëzimi nr.9 të Ministrisë së Financave datë 20.03.2018 "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit".
- Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.22 datë 30.07.2018 për proçedurat standarde të monitorimit të Buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore.

MISIONI I BASHKISË DEVOLL

Bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", misioni i bashkisë është sigurimi i një qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më pranë qytetareve. Realizimi i shërbimeve në përputhje me standartet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative. Respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetareve të saj.

Buxheti u bazua tek politikat e programit të Kryetarit të Bashkisë të cilat ishin:

1. **Zhvillimin parësor të bujqësisë.**
   - Krijimi i hapësirave dhe mundësi që ndihmuan sektorin e produkteve bujqësore që kërkohen nga tregjet kombëtare, rajonale dhe më gjërë.
   - Zhvillimin me përparësi u kushtuam këshillimit kultivimin e frutikulturës, e arrorëve, farorëve dhe bimëve medicinale etj.
   - Rehabilitimin e sistemeve ujitës e kullues të tokës, me synimin për të ujitur 100% të sipërfaqes.
2. **Në infrastrukture.**
   - Ndërtimi i shkollave dhe qëndrës kulturore për zhvillimin dhe promovimin e kulturës së Devollit.
   - Ne realizuam me përpikshmëri rehabilitimin e rrugëve kryesore dhe të lagjeve.
3. **Për kulturën dhe sportin.**
   - Prioritet për të gjithë zonen e Devollit gjithashtu i'u kushtuam, aktiviteteve kulturore dhe sportive, realizuam ngritjen e ansamblit të këngës dhe valles devolliçe sipas grupmoshave.
4. **Turizmi.**
   - Hartimi i guidës turistike të Devollit, si dhe ngritja e grupeve të para për të vizituar vendet më prioritet, zhvillimin e turizmit, lehtësimi i lejëve të ndërtimeve për turizmin malor dhe atë liqeno-lumor, turizmin historik dhe kulturor.
5. **Për pyjet dhe kullotat.**
   - Ne mundësuam ndërhyrjen me masa efektive për rehabilitimin dhe shfrytëzimin racional e me efektivitet të kullotave si dhe pastrimin e disa siperfaqeve.
6. **Për shtresat në nevoje, njerezit me aftësi të kufizuar, emigrantët, romët.**
   - Dhënia e ndihmës ekonomike dhe financiare për familjet në nevojë pa asnjë lloj diferencimi politik e social. Duke u bazuar në politika afatgjata, mundësi punësimi të

romëve dhe shtresave në nevojë, integrimin e tyre në shoqeri, shkollimin dhe strehimin e tyre.

- **Qëllimet e Programit Buxhetor:**

1- Informacion konkret mbi parashikimin e të ardhurave dhe burimeve kryesore si dhe objektivat faktike për se do të shpenzohen ato, shpenzime me qëllim shpërndarjen efektive të burimeve në dispozicion;
2- Zgjerimi i vizionit të procesit të buxhetimit duke synuar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhe afatmesme (3-vjeçare);
3- Një parashikim më i mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhe tre vjeçare, për të gjitha programet e shpenzimeve, duke përcaktuar treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
4- Inkurajimi i efektivitetit, efiçencës dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike dhe alokimin e burimeve;
5- Forcimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskale.

Raporti i III –të i monitorimit përmban:

Aneksi nr.1 "Raporti i shpenzimeve sipas programeve"
Aneksi nr.2 "Raporti i shpenzimeve sipas artikujve Buxhetorë"
Aneksi nr.3 "Raporti i realizimit të objektivave të programit"
Aneksi nr.4 "Treguesit Financiarë"
Aneksi nr.5 "Raporti i investimeve me financim të brëndshëm dhe të jashtëm"

Struktura sipas programeve për Vitin 2025

STRUKTURA ORGANIZATIVE							
Kodi I Prog.	**Emri I Programit**	**Struktura Përbërëse të Programit**	**Numri I punonjësve**				
			2023	**2024**	**2025**	**2026**	**2027**
AA105	Menaxhimi dhe shërbimet Mbështetëse	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi, Planifikimi urban, Shërbimet e policise vendore ,Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	108	119	106	106	106
AB105	Shërbimet Publike Komunitare	Rrjeti rrugor rural, Shërbimet Publike vendore , furnizimi me uje dhe kanalizime	88	85	124	124	124
AC105	Shërbimet Sociale	Përkujdesi dhe strehimi social	30	31	24	24	24
AD105	Arsimi ,Arti Kultura & Sporti	Sport dhe Argetim, Trashegimi Kulturore ,Evente artistike dhe kulturore ,Arsimi baze Arsimi I mesem I	133	136	152	152	152
AE105	Bujqësia Mjedisi dhe Pyjet	Shërbime bujqësore , inspektimi siguria ushqimore dhe konsumatori, Menaxhimi I infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit Administrim I I pyjeve dhe	36	39	38	38	38
		TOTALI	**395**	**410**	**444**	**444**	**444**

Tabela Përmbledhëse e realizimit të të ardhurave sipas zërave per vitin 2024 - 2025

Nr	Emërtimi	Viti 2024				Viti 2025			
		Plan Vjetor	Plani i periudhes- 12 mujore	Fakt Janar-Dhjetor 2024	%	Plan Vjetor	Plani i periudhes- 12 mujore	Fakt Janar-Dhjetor 2025	%
	Te ardhura tatimore								
1	Taksë Ndertese	19,150,000	19,150,000	16,763,881	87.54	19,150,000	19,150,000	15,913,567	83.10
2	Taksë Trualli	3,000,000	3,000,000	2,767,656	92.26	3,000,000	3,000,000	2,788,844	92.96
3	Taksë Toke	21,821,200	21,821,200	13,655,375	62.58	21,737,200	21,737,200	13,488,967	62.05
4	Taksë Tabele	2,000,000	2,000,000	1,276,683	63.83	2,000,000	2,000,000	1,313,478	65.67
5	Taksë Tregu/zenie hapesire publike	1,100,000	1,100,000	928,000	84.36	1,440,000	1,440,000	1,134,860	78.81
6	Taksë Ndikimi në infrastrukture	6,000,000	6,000,000	1,583,773	26.40	4,000,000	4,000,000	4,143,686	103.59
7	Takse Fjetje ne Hotel	60,000	60,000	44,480	74.13	75,000	75,000	62,020	82.69
8	Tatim I Thjeshtuar	90,000	90,000	113,124	125.69	120,000	120,000	69,529	57.94
9	Regj.Autonjeti në përd.	11,000,000	11,000,000	12,702,740	115.48	12,000,000	12,000,000	13,373,020	111.44
10	T. Renta Minerale	20,000	20,000	12,367		20,000	20,000	-	
11	Të ardhura nga ASHK	300,000	300,000	188,726	62.91	200,000	200,000	217,875	108.94
12	Tatim mbi TAP/ardhur per covid	9,000,000	9,000,000	11,997,179	133.30	13,725,115	13,725,115	16,187,967	117.94
13	Takse emergjencash			-	#DIV/0!	-	-	-	#DIV/0!
14	T ardhura te tjera	230,000	230,000	190,654	82.89	230,000	230,000	391,760	170.33
15	Leje per shitje me pakicë të Karburanteve	600,000	600,001	600,000	100.00	4,600,000	4,600,000	4,600,000	100.00
	Shuma I.	**74,371,200**	**74,371,201**	**62,824,638**	**84.47**	**82,297,315**	**82,297,315**	**73,685,573**	**89.54**
	Të ardhura jotatimore		-				-		
1	**Tarifë Pastrimi**	41,632,500	41,632,500	28,459,884	68.36	52,396,000	52,396,000	32,200,790	61.46
2	**Tarifë Ndriçimi**	19,000,000	19,000,000	14,984,702	78.87	20,500,000	20,500,000	15,186,112	74.08
3	**Tarifë Gjelberimi**	2,135,000	2,135,000	1,908,734	89.40	3,135,000	3,135,000	2,009,429	64.10
5	Tarifë Parkimi	870,000	870,000	645,500	74.20	870,000	870,000	721,900	82.98
6	Tarifa te # ne Bashki	1,600,000	1,600,000	1,588,888	99.31	1,600,000	1,600,000	743,060	46.44
7	Të ardhura nga Qeraja Trualli/objekti	3,237,256	3,237,256	6,397,158	197.61	49,373,185	49,373,185	28,014,355	56.74
8	Tarife leje Certefikat transport	790,000	790,000	462,800	58.58	790,000	790,000	406,350	51.44
8	Kullotat			-		6,000,000	6,000,000	3,391,682	
9	Të ardhura te tjera te pa parashikuara	2,178,518	2,178,518	2,178,518	100.00	-	-	-	
10	Mjete koreëse			-		-	-	-	
11	Tarifë Uji per ujë	-	-	-		-	-		#DIV/0!
12	**Tarife per mirmbajtje kanale kullues/tarif**	8,780,000	8,780,000	6,731,310	76.67	8,780,000	8,780,000	8,030,265	91.46
13	Tarifë sherbim varrimi dhe mirmbajtje	6,520,000	6,520,000	5,686,890	87.22	6,520,000	6,520,000	6,312,353	96.82
14	Bileta sporti ,Kulture,udhetimi			-					
15	Tarifa Administrative/cerdhe	960,000	960,000	1,031,140	107.41	1,248,000	1,248,000	1,081,300	86.64
16	Kazan Rakie			-		66,000	66,000	79,250	
17	Leja Non Stop	200,000	200,000	105,000	52.50	200,000	200,000	90,000	45.00
18	Gjoba të #	2,400,000	2,400,000	292,620	12.19	2,000,000	2,000,000	1,074,656	53.73
20	Tarifë sherbim veteriner			-		-	-	-	
21	Tarifë e drejtë televizive			-				-	
22	Sponsorizime	3,312,730	3,312,730	3,312,730	100.00			-	
	Shuma II	**93,616,004**	**93,616,004**	**73,785,874**	**78.82**	**153,478,185**	**153,478,185**	**99,341,502**	**64.73**
III	**Debi e parashikuar per mbledhje**	**34,585,674**	**34,585,674**	**11,628,172**	**33.62**	**31,659,634**	**31,659,634**	**10,640,938**	**33.61**
	Shuma I+II+III		-				-		
	Totali	202,572,878	202,572,879	148,238,683	73.18	267,435,134	267,435,134	183,668,013	68.68

1.Zëri takse ndikimi në infrastrukture ka diference pasi për këtë takse patëm disa arketime të pa planifikuar në vitin 2025 planifikimi është ndryshuar nga 1,300,000 ka ndryshuar në 4,000,000 leke.

2.Taksa e fjetjes ne hotel nuk ka pasur te ardhura per vitin 2024, pasi vjelja per kete tarif ka filluar pas qershorit.

3.Tarifa leje shitje per karburantet planifikimi ka qene me I ulet dhe te ardhurat per kete ze kane qene pas qershorit.

4.Te ardhurat nga qeraja e truallit per vitin 2024 , planifikimi ishte me I ulet dhe te ardhurat per kete ze kane qene pas kesaj periudhe ., planifikimi per kete ze eshte ndryshuar nga 29,165,569 në 49,373,185 mijë lekë.

Totali i Burimeve të Financimit	*Planifikimi 12-mujor 2025*	*Fakti 12-mujor 2025*	*Realizimi 12-mujor 2025*
	267,435	**183,668**	**68.68%**

Të ardhurat për Vitin 2025 për periudhën 12-mujore janë realizuar në masën 183,668 mijë lekë ose 68.68% të planit.

Të ardhurat tatimore për periudhën Janar –Dhjetor 2025 janë realizuar në shumën 73,686 **mijë lekë**, ose **89.54 %** e planit të 12-mujorit të vitit 2025, krahasuar me vitin 2024 të ardhurat tatimore për periudhën 12-mujore janë realizuar në masën 62,825 mijë lekë ose 84.47 % e planit. Për vitin 2025 kemi një realizim me vlerë më të lartë me 10,861 mijë lekë më shumë, përqindja e realizimit të të ardhurave tatimore për periudhë 12- mujore për vitin 2025 është më e lartë se sa përqindja e realizimit në vitin 2024. Në vitin 2025 për periudhën 12- mujore kemi realizuar një planifikime më të drejte të të ardhurave krahasuar me 12- mujorin e vitit 2024. Zëra që kanë peshë në këtë grup dhe njëkohësisht kanë realizim mbi 100% janë zërat, Taksë ndikimi në infrastrukture e cila është realizuar 104%, ndërsa në vitin 2024 ka një realizim shumë të ulët, pasi në vitin 2025 kemi pasur disa arkëtime të pa planifikuara.

Të ardhurat jo tatimore për periudhën Janar –Dhjetor 2025 janë realizuar në shumën **99,342 mijë lekë**, ose **64.73%** e planit të 12-mujorit të vitit 2025. Krahasuar me vitin 2024 për

periudhën 12- mujore të ardhurat jotatimore për periudhën faktike janë realizuar në masën **73,786** mijë lekë ose **78.82%** e planit, në vitin 2024 kemi përqindje realizimi më të madhe për arsye se plani është planifikuare **93,616** mijë lekë dhe në vitin 2025 plani është planifikuar me **59,862** mijë lekë më shumë. Në zërat që kanë peshë mund të përmëndim tarifë për mirëmbajtje kanale kulluese në masën **91,46%** krahasuar me vitin 2024 kemi patu një përqindje më të ulët me **76.67%** tarif shërbimi varrimi dhe mirëmbajtje me **96.82%** .

Të ardhurat nga qeraja e truallit për vitin 2024, ka patur planifikim më të ulët dhe të ardhurat për këtë zë kanë qënë pas kësaj periudhe,planifikimi për këtë zë është ndryshuar gjatë vitit 2025 nga **29,166** mijë lekë në **49,373** mijë lekë.

Debia nga Viti 2025 për periudhën 12- mujore është realizuar në masën **10,640** mijë ose 33.61% krahasuar me planin, në krahasim me vitin 2024 ky vitë ka një ulje të debisë , në vlerën 987 mijë lekë.

Tabela më poshtë paraqet të ardhurat tatimore, jotatimore, dhe sponsorizimet.

Emërtimi	Fakti 2024 12-mujor	Plani 2025 12-mujor	Fakti 2025-12-mujor
Të ardhura Tatimore	62,824.64	82,297.32	73,685.57
Të ardhura jotatimore	73,785.87	153,478.16	99,341.50
Debia	11,628.17	31,659.63	10,640.94

TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR

Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit u jepet njësive të vetqeverisjes vendore, për financimin e ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tyre të percaktuara me ligj. Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga burimet e veta, janë burimi kryesor i buxhetit të bashkisë. Bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga ligji 139/2015 për vetëqeverisjen vendore. Gjatë 12-mujorit te vitit 2025, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat për kryerjen e funksioneve më të nevojshme.

Ecuria e Transfertës së pakushtëzuar.

	Viti	Shuma e transfertës	Rritja
Rendi Rritës I Transfertës së Pakushtëzuar	2019	184,579	0
	2020	189,509	4,930↑
	2021	193,299	3,790↓
	2022	199,230	5,931↑
	2023	230,606	31,376↑
	2024	272,047	41,441↑
	2025	342,856	70,809↑

TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE

Transferta e pakushtëzuar sektoriale përdoret për të financuar funksionet e transferuara si më poshtë:

- Financimin e funksioneve të reja të transferuara te njësit e vetëqeverisjes vendore, për një periudhë tranzitore deri në përcaktimin e një skeme ekuivalente dhe të qëndrueshme financimi .
- Financimin e shërbimeve në raste të emergjencave për të kryer funksionet si më poshtë:

1.Arsimi parashkollor, edukatore dhe punonjëse në qëndrat kulturore të fëmijëve.

2.Arsimi paraunversitar, punonjës të shërbimeve mbështetëse në arsim I mesëm.

3.Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi .

4-Administrimi I Pyjeve.

5-Administrimi I rrugëve rurale.

6-Administrimi i ujitjes dhe kullimi.

7-Emergjencat Civile.

Nr.	Programi	Emërtimi i njësive shpenzuese	Nr i punonjësve
1	9120	Arsimi parashkollor	69
2	9230	Arsimi parauniversitar	4
3	3280	Emergjencat Civile	14
4	4260	Administrimi i Pyjeve	6
5	4260	Ujitja e Kullimit	4
TOTALI			**97**

Për secilin funksion është bërë shpërndarja dhe përllogaritja sesi janë përdorur këto fonde. Kjo është rekomanduar nga Qeverisja Qëndrore dhe ne kryejmë specifikimet përkatëse për shpenzimet operative, të cilat përcaktohen duke marrë për bazë shpenzimet e vitit të kaluar.

	Viti	Shuma e transfertës	Rritja
Rendi Rritës I Transfertës Specifike	2019	92,411	0
	2020	95,277	↑2,866
	2021	100,948	↑5,671
	2022	104,179	↓3,231
	2023	108,560	↑4,381
	2024	117,447	↑8,887
	2025	151,590	↑34,143

Viti 2025 është viti i cili për bashkinë tone akordohet për here të parë një fond për mbetjet urbane, për vitin 2025 ky fond është 8,000 mijë lekë.

Detyrimet e prapambetura Janar-Dhjetor 2025.

Detyrimi	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025 Janar-Dhjetor
4864200-4864600 Mallra dhe Sherbime	15,820,200	32,992,145	1,354,645
4864400 Investime	77,654,909	3,510,993	0
Vendime Gjyqesore	0	0	0
4864201 Energji Elektrike	421,958	421,958	0
Totali	**93,897,067**	**36,925,096**	**1,354,645**

Për periudhën Janar-Dhjetor për vitin 2025 detyrimet e prapambetura jane gjithsej në vlerën **1,354,645** ndersa në vitin 2024 detyrimet e prapambetura kanë qenë në vlerën **36,925,096** pra në vitin 2025 kemi një ulje të detyrimeve të prapambetura me vlerën **35,570,451** krahasuar me vitin 2023 në vitin 2024 kemi një recesion të detyrimeve të prapambetura me vlerën **56,971,971** lekë dhe në periudhën 12- mujore të vitit 2025 kemi një ulje krahasuar me vitin 2023 në vlerën **92,632,422** lekë të detyrimeve .

Në vitin 2025 në periudhën 12- mujore detyrimet e prapambetura shfaqen më të ulta në krahasim me vitin 2024 pra ne 12- mujorin e vitit 2025 kemi likuiduar me shume detyrime te prapambetura, pasi kemi pasur mbështetje financiare nga Ministria e financave.

Kalendari i Shlyerjes së vlerës 1,354,645 lekë është parashikuar të likuidohet gjatë 4- mujorit të pare të vitit 2026.

Raporti i shpenzimeve sipas programeve

Referuar ANEKSIT nr.1 "Raporti i shpenzimeve sipas programeve " për vitin 2025. Shpenzimet për vitin 2025 për periudhën 12- mujore, janë realizuar në total në vlerën **640,518.**[35] mijë lekë, në krahasim me planin vjetor realizimi është **0.74%,** krahasuar me vitin 2024 perqindja e realizimit të totalit të buxhetit është **0. 81%**, viti 2024 ka realizim më të madh se viti 2025 për arsye se në vitin 2025 planifikimin buxhetor ka qenë **119,238 lekë** më shumë se në vitin 2024.

Programi AA105 "Menaxhimi dhe shërbimet mbështetëse"

<u>Qëllimet dhe objektivat e programit janë:</u>

Qëllimi 1: Nxitja e përmirësimit të proceseve të menaxhimit dhe administrimit të bashkisë nëpërmjet zbatimit me profeionalizëm të përcaktimeve ligjore, ofrimit të shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve të cilat përmirësojnë ndjeshëm jetën e qytetarëve dhe aksesin në shërbime publike.
Objektivi 1.1: Rritja e përformancës së administratës së aparatit të bashkisë përmes zbatimit të metodologjive moderne të menaxhimit të brendshëm të burimeve njerëzore. Përmirësimi i kohës së informimit dhe shërbimeve të tjera administrative të aparatit të bashkisë.
Objektivi 1.2: Ndjekja dhe zbatimi i Planit të Përgjithshëm Vendor si dhe hartimi i planeve të Detajuara Vendore për ti dhënë zhvillim territorit për investime publike.
Objektivi 1.3: Zbatimi i marrëveshjeve ndërinstitucionale të nënshkruara nga Bashkia Devoll, në funksion të plotësmit të detyrimit ligjor për të qënë sa më afër qytetarëve në të gjitha shërbimet.
Qëllimi 2: Inspektimi, parandalimi, masat mbrojtëse nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpetimi i jetës, pronës, njedisit. Përdorimi me efikasitet i teknikës zjarrfikëse, përballimi i cdo situate emergjence, rritja e nivelit tekniko-profesional i punonjësve, trajnimi i

vazhdueshëm i tyre.

Objektivi 2.1: Rritja e gadishmërise së stafit , për përballimin e cdo situate në kohë sa më të shkurtër dhe në mënyrë sa më efektive.
Objektivi 2.2: Parandalimi i kundërvajtjeve administrative dhe konflikteve nga ana e shërbimeve të policisë vendore me qëllim sigurimin e rendit, qetësisë, mbarëvajtjes së punëve publike dhe zhvillimit normal të jetesës në komunitet.

Në këtë program janë parashikuar shpenzime për 106 punonjës. Aktualisht në këtë program për periudhën 12-mujore janë gjithsej 96 punonjës faktikë. Referuar aneksit të shpenzimeve për periudhën 12- mujore të vitit 2025, shpenzimet faktike janë realizuar në vlerën **145,131 mijë lekë,** ose **0.74 %** në krahasim me planin, krahasuar me vitin 2024 perqindja e realizimit ka qenë **0.79%** pra në vitin 2024 kemi një realizim më shumë se sa në vitin 2025, për arsye se në vitin 2025 kemi një planifikim më shumë të planit në masën **46,393** mijë lekë.

Programi AB105 "Shërbime publike dhe komunitare"
<u>Qëllimet dhe objektivat e programit janë:</u>

<u>Qëllimi 1:</u> Ndikimi në cilësinë e jetës së qytetarëve të bashkisë përmesë përmirësimit të infrastrukturës rrugore rurale dhe sinjalistikës të cilat janë nën adminsitrimin e bashkisë dhe agjensise së krijuar pë të qënë sa më prane qytetarëve. Mirëmbajtja në kilometër e rrjetit rrugor, trotuarve të ndricimi të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ndërtimi dhe rehabilitimi i kanaleve të ujitjes dhe kullimit.
Objektivi 1.1: Mirëmbatjtja dhe shtesa në kilometër i rrugëve rurale brenda territorit të bashkisë. Përmirësimi i sinjalistikës rrugorë të bashkisë.
Objektivi 1.2: Mirembajtja e rrugëve në zonat urbane, rehabilitimi i rrugëve të reja, pastrimi dhe larja e tyre. Pastrimi dhe mirëmbajtja e trotuareve si dhe shtimi i siperfaqeve të reja.
<u>Qëllimi 2:</u> Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, ndotjes mjedisore dhe krijimit të hapsirave të gjelbërta brenda territorit të bashkisë, në funksion të shtesës së hapsirave rekreative.
Objektivi 2.1: Rritja e sipërfaqes publike të pastruar dhe të mirëmbajtur në masën 90% (në sipërfaqe territoriale, koherente kjo me 100% përfitim i shërbimit nga familjet) në hapsirat e gjelbërta dhe brenda blloqeve të pallateve. Mbajtja e standartit 100% dhe për periudhen 2023-

2028. Sipërfaqe publike e pastruar dhe e mirëmbajtur në njësitë administrative dhe rehabilitim i varrezave dhe shtim i sipërfaqes së tyre. Kryerja e kontrollove të rregullta të mirëmbajtjes së kamionëve të pastrimit të mbeturinave, 6 kamionë për Nj.A. dhe 2 mjete në qytet.

Objektivi 2.2: Rritja e sipërfaqes publike të pastruar dhe të mirëmbajtur në masën 90% (në sipërfaqe territoriale, koherente kjo me 100% përfitim i shërbimit nga familjet) në hapsirat e gjelbërta dhe brenda blloqeve të pallateve. Mbajtja e standartit 100% dhe për periudhen 2023-2028. Sipërfaqe publike e pastruar dhe e mirëmbajtur në njësitë administrative dhe rehabilitim i varrezave dhe shtim i sipërfaqes së tyre. Kryerja e kontrollove të rregullta të mirëmbajtjes së kamionëve të pastrimit të mbeturinave, 6 kamionë për Nj.A. dhe 2 mjete në qytet.

Objektivi 2.3: Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i sipërfaqes së gjelbëruar në territorin e Bashkisë Devoll. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i shërbimit të varrezave.

Qëllimi 3: Sigurimi i një mbulimi efikas të energjisë për ndriçimin publik për 90% të zonës urbane dhe 80% në zonat rurale të territorit të Bashkisë deri në 2026.

Objektivi 3.1: Sigurimi i një mbulimi efikas të energjisë për ndriçimin publik për 90% të zonës urbane dhe 80% ne zonat rurale të territorit të Bashkisë deri në 2026.

Qëllimi 4: Mirëmbajtje e 70% të objekteve në pronësi të bashkisë.

Objektivi 4.1: Mirëmbajtje e 70% të objekteve në pronësi të bashkisë.

Numri i punonjësve në këtë program është planifikuar 124 punonjës, dhe aktualisht për periudhën 12-mujore janë 132 punonjës,të cilët menaxhohen nga sektori i Agjensise , referuar aneksit të shpenzimeve për periudhën 12- mujore të vitit 2025, shpenzimet faktike janë realizuar në vlerën **241,489** mijë lekë, ose **0. 79%** e planit, krahasuar me vitin 2024 perqindja e realizimit është **0. 85%** pra në vitin 2024 kemi një përqindje realizimi më shumë për arsye se kemi një diference në plan, në vitin 2025 kemi arritur të planifikojmë më shumë me **28,366** mijë lekë më shumë.

Programi AC105 "Shërbime sociale"

Qëllimet dhe objektivat e programit janë:

Qëllimi 1: Të garantojë funksionimin e një sistemi cilësor dhe të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe të sigurojë akses pa barriera për mirëqënie sociale me dinjitet, pa asnjë lloj diskriminimi, duke respektur të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

Objektivi 1.1: Kujdesi social për familjet që përfitojnë shërbime nga Bashkia Devoll. Mbulimi i një numri sa më të madh i grupeve në nevojë të cilët sipas legjislacionit në fuqi duhet të përfitojnë nga shërbimet sociale.

Objektivi 1.2: Kujdesi social për femijet që përfitojnë shërbime nga Bashkia Devoll. Mbulimi i një numri sa më të madh i grupeve në nevojë të cilët sipas legjislacionit në fuqi duhet të përfitojnë nga shërbiemt sociale.

Objektivi 1.3: Sigurimi dhe kujdesi per familjet që mbajnë statusin i pastrehë në Bashkinë Devoll në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Numri i punonjësve të planifikuar për këtë program është 24 punonjës, dhe aktualisht janë të gjithsej 24 punonjës. Referuar aneksit të shpenzimeve për periudhën 12- mujore të vitit 2025, shpenzimet faktike janë realizuar në vlerën **33,898** mijë lekë **0.73 %** e planit, krahasuar me vitin 2024 perqindja e realizimit ka qene **0.88%** , në vitin 2024 kemi pasur një perqindje realizimi më të lartë se sa në vitin 2025.

Programi AD105 "Arsimi, arti, kultura dhe sporti"

Qëllimet dhe objektivat e programit janë:

Qëllimi 1: Promovimi i trashëgimisë kulturore, historike dhe vlerave arkitekturore si pasuri e trashëgimisë kombëtare.

Objektivi 1.1: Shtimi i aktiviteteve për promovimin e vlerave kulturore dhe historike të zonës së Devollit

Objektivi 1.2: Rritja e numrit të vizitorëve dhe lexuesve të të gjitha moshave në bibliotekën e qytetit.

Qëllimi 2: Pjesëmarrja e sa më shumë ekipeve cilësore të klubit tonë në aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare, për të përfaqësuar sa më denjësisht qytetin dhe kombin në këto aktivitete.

Objektivi 2.1: Realizimi i rezultateve (pikëve mesatare) për sportistët tanë të sporteve individuale dhe renditjeve ekipore në sportet kolektive, bazuar kjo në kontratat e nënshkruara me ta në fillim të sezonit.

Qëllimi 3: Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i rregullt i infrastrukturës së arsimit për të siguruar mjedisin e duhur të mësimdhënies. Rritja e numrit të shkollave që përmbushin standardet arsimore të mjedisit fizik si dhe përmirësimi i nivelit të mësimdhënies nëpërmjet stafit të kualifikuar.

Objektivi 3.1: Përmirësimi i infrastrukturës së arsimit për të siguruar mjedisin e duhur të mësimdhënies
Objektivi 3.2: Rritja e nivelit të mesimdhenies nëpërmjet ofrimit të shërbimit të stafit mësimor dhe mbështetës.

Numri i punonjësve të planifikuar për këtë program është 152 punonjës, dhe aktualisht janë të gjithë punonjësit 152 punonjës. Referuar aneksit të shpenzimeve për periudhën 12- mujore të vitit 2025, shpenzimet faktike janë realizuar në vlerën **172,385** mijë lekë ose **0.75 %** e planit, krahasuar me vitin 2024 perqindja e realizimit ka qenë **0.80%** , pra në vitin 2024 kemi pasur një realizim më të madh faktik për arsye se në vitin 2025 plani ka qenë me I lartë në masën **27,414** mijë lekë më shumë.

Programi AE105 "Bujqësia, mjedisi dhe pyjet"
Qëllimet dhe objektivat e programit janë:
Qëllimi 1: Pyjet dhe Kullotat. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i hapësirave të pyje-kullotave mbi 100% të sipërfaqes, rritja e kapaciteteve shfrytëzuese të sipërfaqes kullosore dhe pyjore mbi 30% të territorit të bashkisë brenda vitit 2025.
Objektivi 1.1: Menaxhimi dhe monitorimi i sipërfaqes pyjore dhe kullosore, shfrytëzimi i sipërfaqes mbi 97% të territorit në administrim të bashkisë.
Qëllimi 2: Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastruktures së ujitjes dhe kullimit
Objektivi 2.1: Përmirësimi i sistemit ujitës dhe kullimit nëpërmjet organizimit të sistemeve të kontrollit mbi rastet e përmbytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit dhe furnizimit me ujë të fermave bujqësore me rreth 2.6% të totalit.
Objektivi 2.2: Përmirësimi i sistemit ujitës dhe kullimit nëpërmjet organizimit të sistemeve të kontrollit mbi rastet e përmbytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit dhe furnizimit me ujë të fermave bujqësore me rreth 2.6% të totalit.

Qëllimi 3: Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore, krijimi i informacionit kadastral dhe bujqësor.

Objektivi 3.1: Krijimi dhe përditësimi i informacionit të regjistrit kadastral për administrimin dhe përdorimin e tokës bujqësore.

Qëllimi 4: Mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetareve. Zbatimin e dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit dhe të përbërësve të tij. Ndërgjegjësimi i banorëve nëpërmjet promovimit të politikave edukuese për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Numri i punonjësve të planifikuar në këtë sektorë është 38 punonjës, dhe aktualisht janë 37 punonjës . Referuar aneksit të shpenzimeve për periudhën 12- mujore të vitit 2025, shpenzimet faktike janë realizuar në vlerën **46,967** mijë lekë ose **0.57%** e planit, krahasuar me vitin 2024 perqindja e realizimit faktik ka qenë **0.73%** pra në vitin 2024 kemi realizuar më shumë likuidime se sa në vitin 2025, për arsye se në vitin 2025 kemi planifikuar me shumë shenzime në vlerën 16,070 mijë lekë me shume se sa viti 2024.

INVESTIMET

ANEKSI nr.5 "PROJEKTET E INVSTIMEVE ME FINANCIM TE BRENDSHEM DHE ME FINANCIM TE HUAJ

Projektet me financim të brendshëm (në 000/lekë)

Kodi projektit	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2025	REALIZIMI për periudhën e raportimit (12- mujore)	PROGRESI V nga fillimi i projektit deri në periudhën	Komen
P066AAA	Përmirësimi i banesave për komunitete të pafavorizuara	39,487.49	2025	2026	59,245.50	7,898.00	6,344.22	37,864.22	Përfundu
M100399						31,590.00	31,520.00		Në proç
P066AAA	Kolaudim "Përmirësimi i banesave për komunitete të pafavorizuara " 2024-20	48.22	2024	2025	48.22	48.22	46.80	46.80	Përfundu
P066AAA	Supervizim "Përmirësimi i banesave për komunitete të pafavorizuara "	424.50	2024	2025	359.36	424.50	143.74	143.74	Përfundu
P452AAD	Loti I "Rehab. i rrugëve te brendshme Bilisht" 2023-2025	13,504.41	2023	2025	9,275.99	6,028.72	6,028.48	9,275.75	Përfundu
P452AAD	Loti IV "Rehab.i rrugëve të fshatit Progër" 2023-2025	4,993.32	2023	2025	3,384.00	2,263.98	2,257.64	3,377.66	Përfundu
P452AAD	Loti V " Rehabilitimi I rrugëve të fshatit Miras"		2023	2025		3,517.84	3,517.84	3,517.84	Përfundu
P452AAD	Loti i III "Rehab.i rrugëve të fshatit Bitinckë" 2023-2025	7,778.90	2023	2025	5,408.76	2,584.89	2,584.89	5,408.62	Përfundu
P452AAD	Loti i II "Rehab.i rrugëve të fshatit Poncarë" 2023-2025	11,158.13	2023	2025	7,155.00	3,405.14	3,405.14	7,154.88	Përfundu
P452AAD	"Rehabilitim rruga Dobranj-Braçanj"	21.027.81	2024	2025	12,775.36	12,775.36	12,775.36	12,775.36	Përfundu
P452AAD	"Supervizim rruga Dobranj-Braçanj"	470.70	2024	2025	470.70	470.70			Në proç
P424AAC	Kolaudim objekti "Perroi I fshatit Dobranj"	74.23	2024	2025	74.23	74.23	29.48	29.48	Në proç
P424AAC	Supervizim objekti "Perroi I fshatit Dobranj"	298.38	2024	2025	298.38	298.38			Në proç
P424AAC	Kolaudim objekti " Mbrojtje nga ujerat e larta të përroit të SMT"	310.73	2024	2025	310.73	310.73	123.37	123.37	Përfundu
P424AAC	Supervizim objekti " Mbrojtje nga ujerat e larta të përroit të SMT"	986.77	2024	2025	986.77	986.77	986.77	986.77	Përfundu
18AJ958	"Kanali Ujites Poloske-Inonisht"	5,795.11	2024	2025		5,795.11	5,470.60	5,470.60	Përfundu
P424AAC	Supervizim objekti "Kanali ujites Polosk-Inonisht"	522.99	2024	2025	522.99	522.99	309.71	309.71	Përfundu
P424AAC	Kolaudim objekti "Kanali ujites Polosk-Inonisht"	78.45	2024	2025	78.45	78.45	38.71	38.71	Përfundu
P424AAC	Supervizim objekti " Perroi I fshatit Dobranj"	298.38	2024	2025	298.38	298.38			Në proç
P424AAC	Kolaudim objekti " Perroi I fshatit Dobranj"	44.75	2024	2025	44.75	44.75			Në proç
P424AAC	Kolaudim objekti " Perroi I fshatit Dobranj"	29.48	2024	2025	29.48	29.48		29.48	Përfundu
P633AAB	"Mbikqyrje Ujesjellesi fshati Hoçisht"	230.67	2024	2025	230.67	230.67	230.67	230.67	Përfundu
P452AAD	Sistemim dhe asfaltim "Aksi Vishocice Braçanj-Kurile"		2025	2026	50,166.72	21,979.25			Në proç
V923AAB	Rehabilitimi I terreneve sportive te shkolles se mesme "Fuat Babani"	5,156.07	2025	2026		3,405.00			Në proç
	TOTALI	91,691.68			151,164.44	105,061.54	75,813.42	86,783.66	

Emri	Kryetari Njësisë Vetëqeverisjes Vendore
Firma	Eduard Duro
Data	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL


1-Pjesa më e madhe e investimeve kanë përfunduar në vitin 2025, një ndër investimet kryesore qe është hartuar në vitin 2025, është ' Sistemimi dhe asfaltimi "Aksi Vishocice Braçanj-Kurile" e cila është hartuar si urdher prokurim në vlerën 50,166.72 mijë lekë në vitin 2025 dhe pritet të hartohet kontrata në vitin 2026 për likuidimin e fondit, e cila do te ndahet pergjatë dy viteve 2026-2027.

2-Një tjeter investim që pritet të bëhet për vitin 2026 është "Rehabilitimi I terreneve sportive të shkollës së mesme Fuat Babani" e cila u planifikua që të bëhesh për vitin 2025 por për shkak të pakësimit të fondeve nga Ministria e Financave do të likuidohet në vitin 2026.

TREGUESIT FINANCIAR

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Bashkia Devoll
Treguesit Financiarë (sipas percaktimeve të nenit 54 të Ligjit 68/2017)

Nr.	Treguesit Financiar	Kuptimi	Formula	Fakti viti (t-1)	Plani viti (t)	Plani viti (t+1)	Plani viti (t+2)	Plani viti (t+3)
1*	Raporti I shpenzimeve te pergjithshme ndaj te ardhurave te pergjithshme	Ky raport tregon shpenzimet si nje perqindje kundrejt te ardhurave -raporti tregon sesa shpenzon njesia per ofrimin e sherbimeve publike. Tregon marredhenien midis flukseve hyrese te te ardhurave me flukset dalese te shpenzimeve	Shpenzime/Ardhura *100	3.68	2.73	3.43	3.24	3.31
2*	Raporti I te ardhurave te veta vendore ndaj te ardhurave te pergjithshme	Tregon qendueshmerine fiskale te njesis Rritja e raport ne vite tregon se njesia nuk mbeshtetet vetem ne burime te jashtme si (transfertat e qeverise qendrore grantet etj.)	Të Ardhurat e veta/Të Ardhurat e pergjithshme *100	0.27	0.37	0.29	0.31	0.30
3*	Raporti I te ardhurave faktike nga taksat dhe tarifat vendore ndaj planit te tyre	Nje diference e madhe ose ne rritje midis te ardhurave te arketuara dhe atyre te planifikuara , pergjate viteve mund te tregoje nje renie te pergjithshme te ekonomise vendore. Nese kjo diference eshte e perhershme , atehere problem eshte mbledhja e taksave dhe tarifave vendore , qe mund te jete per shkak te procedurave ,barres se larte fiskale , ose parashikimi i pasakte.	Te Ardhurat faktike nga taksat dhe tarifat /Plani I taksave dhe tarifave*100	0.73	0.69	0	0	0
4*	Raporti I shpenzimeve per investime kapitale ndaj shpenzimeve te pergjithshme	Nje norme e larte nje menaxhim te mire te financave vendore duke ofruar permisime ne sherbimet vendore . Rritja e raporit pergjate viteve , mund te shpjegohet edhe me sherbime shtese , infrastrukture e re , pasuri te paluajtshme te shtuara , funksione te reja te marra qe kane nevoje per investime etj	Shpenzime kapitale/Shpenzime te pergjithshme*100	0.15	0.13	0.05	0.07	0.09
5*	Raporti I shpenzimeve per personelin ndaj shpenzimeve te pergjithshme	Rritja ne vite e peshes se shpenzimeve te personelit ndaj shpenzimeve te pergjithshme , mund te tregoje ulje te shpenzimeve per investime / operative ose faktin se produktiviteti I personelit eshte ne renie . Nje rritje e ketij raporti , mund te tregoi gjithashtu se qeveria , po ofron me shume sherbime (duke marre funksionet e reja , duke rritur volumin e sherbimeve ose cilesin e tij)	Shpenzimet e Personelit/Shpenzimet e Pergjithshme*100	0.40	0.38	0.62	0.60	0.59
6*	Raporti I huamarrjes afatgjate ndaj te ardhurave te pergjithshme	Afatgjate nbi nje vit , Nje raport I ulet tregon qe NJQV-ja eshte ne gjendje te paguaje detyrimet e saj te borxhit (principal+interesat) Nese NJQV-ja po paguan nje perqindje te larte te te ardhurave totale ne sherbimin e borxhit , ato mund te detyrohen te ulin sherbimet e tjera lokale	Borxhi afatgjate I akumuluar/Te ardhurat e pergjithshme *100	0	0	0	0	0
7*	Raporti I huamarrjes afatgjate ndaj te ardhurave te veta	Raporti tregon nje varesi midis sherbimit te borxhit /shlyerjes me ane te burimeve te veta financiare , te njesise se veteqeverisjes vendore	Borxhi afatgjate I akumuluar/Te ardhurat e veta *100	0	0	0	0	0
8*	Raporti I huamarrjes afatshkuter ndaj te ardhurave te pergjithshme	Afat shkuter nen nje vit.Tregon aftesine e njesise vendore per te respektuar detyrimet afatshkutura . Rritja e detyrimeve korente afatshkutera si % kundrej te ardhurave ne fund te vitit tregon nje situate negative ne lidhje me likuiditetet dhe ose problem me shpenzimet te cilet realizohen me borxh. Nje raport i ulet tregon se borxhi afatshkuter mund te shlyhet lehtesisht me ane te te ardhurave vjetore te njesise	Borxhi Afatshkuter/Te Ardhurat e pergjithshme*100	0.05	0.00	0	0	0
9*	Raporti I detyrimeve tatimore te paarketuara ne kohe ndaj te ardhurave tatimore	Perfaqeson detyrimet fiskale te papaguara ne kohe per njesin vendore . Nje norme e larte e detyrimeve te akumuluara kundrejt totalit te te ardhurave te njesis nga taksat dhe tarifat , mund te tregoi proceduara , jo te mira , barre e lart fiskale , renie te ekonomise vendore	Detyrimet Tatimore te Prapambetura /Te Ardhurat nga Taksat dhe Tarifat*100	0.11	0.11	0.02	-	-
10*	Raporti I shpenzimeve per partneritet publike-private ndaj shpenzimeve te pergjithshme.	Raporti I shpenzimeve qe ben njesia si pjese e te gjitha skemave PPP ku ajo eshte pale nuk duhet te jete me shume sesa 5% shpenzimeve te pergjithshme te saj Raporte me te larta tregojne se njesia eshte ne kundershtim me parashikimet ligjore numer 9936/2008"Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH i ndryshuar	Shpenzimet e njesis per PPP/Shpenzimet e pergjithshme te njesis *100	0	0	0	0	0
11*	Raporti I shpenzimeve per politikat e kujdesit shoqeror ndaj shpenzimeve te pergjithshme	Nje raport I lart tregon ndermarrjen e politikave te reja ose masa ne fushen e sherbimeve sociale ose rritje te numerit te perfituesve te ketyre politikave /masave	Shpenzimet per Sherbimet sociale /shpenzimet e pergjithshme*100	0.06	0.06	0.05	0.05	0.05
12*	Raporti I shpenzimeve per politikat qe mbeshtesin barazine gjinore ndaj shpenzimeve te pergjithshme	Njesia perdor fonde per politika qe mbeshtesin ceshtjet gjinore dhe nje raport ne rritje pergjate viteve tregon angazhimin ne rritje te njesise ne kete fushe	Shpenzimet per ceshtjet e barazise gjinore /shpenzimet e pergjithshme	0	0	0	0	0
Emri		Kryetari Njësisë Vetëqeverisjes Vendore						
Firma		Edmond Duro						
Data								



Publikimi

Anekeset e monitorimit për 12-mujorin e vitit 2025, janë publikuar brenda datës …27.02.2026……në faqen e Web Side: bashkiadevoll.gov.al Transparenca dhe Llogaridhënia .

Pika 7-Monitorimi dhe Mbikqyrja e Buxhetit.

Konceptoi: E.Bejolli

Pranoi: B. Diko

Miratoi: A. Furxhi

Konfirmoi: A.Rushitaj

Eduard DURO

KRYETARI I BASHKISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/lekë

Emri i Grupit						Kodi i Grupit		
Programet		Shpenzimet e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore						
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti	PBA	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor		
Titulli	Emërtimi	Fakti i vitit paraardhës Viti 2024	Viti 2025	Plan Fillestar Viti 2025	Plan i Rishikuar Viti 2025	Plani i periudhës/progresive 12 - mujore	Fakti i periudhës/progresive 12- mujore	Diferenca
AA105	Menaxhimi dhe shërbime mbështetëse	118,833.51	137,546.00	183,911.76	196,646.26	196,646.26	145,130.91	(51,515.35)
AB105	Shërbime publike dhe komunitare	237,079.33	285,325.00	243,460.46	307,325.33	307,325.33	241,489.50	(65,835.83)
AC105	Shërbime sociale	39,647.68	29,893.00	38,240.55	46,567.65	46,567.65	33,898.55	(12,669.10)
AD105	Arsimi, arti, kultura dhe sporti	162,034.25	139,305.00	214,563.35	230,421.33	230,421.33	172,384.99	(58,036.34)
AE105	Bujqësia, mjedisi dhe pyjet	48,507.52	38,791.00	70,913.40	82,314.71	82,314.71	46,967.00	(35,347.71)
AF105	Fondi rezervë dhe kontigjenca	478.50	-	-	2,085.32	2,085.32	647.40	(1,437.92)
Totali		606,580.79	630,860.00	751,089.52	865,360.60	865,360.60	640,518.35	(224,842.25)

Emri	Kryetari i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore
Firma	Eduard DURO
Data	

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

ne 000/lekë

Bashkia	Devoll						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2105001
Programi	"MENAXHIMI DHE SHERBIME MBESHTETESE"						Kodi i Programit	AA105
Art.	Emërtimi	-1	-2	3	4	5	6	7
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2024	PBA Plan Viti 2025	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2025	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2025	Buxheti Vjetor Plani i periudhës progresive 12- mujore	Fakti i periudhës progresive 12 - mujore	Diferenca
600	Paga	79,750.93	85,957.00	121,569.61	124,565.26	124,565.26	94,682.18	(29,883.08)
601	Sigurime shoqërore	13,059.09	14,355.00	19,968.19	20,465.23	20,465.23	15,368.63	(5,096.60)
602	Mallra dhe shërbime të tjera	23,117.97	21,514.00	37,158.96	43,684.00	43,684.00	31,848.79	(11,835.21)
603	Subvencione	-	-					-
604	Transferta korrente të brendshme	0.88	3,817.00		336.77	336.77		(336.77)
605	Transferta korrente të huaja	-	-					-
606	Trans për buxh. fam. & individ	-	1,350.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00	597.75	(402.25)
Nen-Totali	*Shpenzime korrente*	*115,928.87*	*126,993.00*	*179,696.76*	*190,051.26*	*190,051.26*	*142,497.35*	*(47,553.91)*
230	Kapitale të patrupëzuara	2,904.64	1,550.00					-
231	Kapitale të trupëzuara	-	9,003.00	4,215.00	6,595.00	6,595.00	2,633.56	(3,961.44)
232	Transferta kapitale	-	-	-	-	-	-	-
Nen -Totali	*Shpenzime kapitale me financim të brendshëm*	2,904.64	10,553.00	4,215.00	6,595.00	6,595.00	2,633.56	(3,961.44)
230	Kapitale të patrupëzuara	-	-	-	-	-	-	-
231	Kapitale të trupëzuara	-	-	-	-	-	-	-
232	Transferta kapitale	-	-	-	-	-	-	-
Nen -Totali	*Shpenzime kapitale me financim të huaj*	-	-	-	-	-	-	-
Totali	*Shpenzime kapitale*	*2,904.64*	*10,553.00*	*4,215.00*	*6,595.00*	*6,595.00*	*2,633.56*	*(3,961.44)*
Totali (korrente + kapitale)		118,833.51	137,546.00	183,911.76	196,646.26	196,646.26	145,130.91	(51,515.35)
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit		Emri	Kryetari Njësisë Vetëqeverisjes Vendore			Emri	TAB.1	
Nardi Hoxha		Firma	Eduard Duro			Firma		
		Data				Data		

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

ne 000/lekë

Bashkia	Devoll						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2105001
Programi	"SHERBIME PUBLIKE DHE KOMUNITARE"						Kodi i Programit	AB105
Art.	Emërtimi	-1	-2	3	4	5	6	7
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2024	PBA Plan Viti 2025	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2025	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2025	Buxheti Vjetor Plani i periudhës progresive 12- mujore	Fakti i periudhës progresive 12 - mujore	Diferenca
600	Paga	42,600.20	54,161.00	84,369.77	84,477.06	84,477.06	69,642.83	(14,834.23)
601	Sigurime shoqërore	7,237.43	9,045.00	14,089.57	14,089.57	14,089.57	11,676.91	(2,412.66)
602	Mallra dhe shërbime të tjera	115,114.60	92,024.00	125,200.54	152,167.64	152,167.64	126,830.58	(25,337.06)
603	Subvencione	-	-	-	-	-	-	-
604	Transferta korrente të brendshme	-	-	-	-	-	-	-
605	Transferta korrente të huaja	-	-	-	-	-	-	-
606	Trans për buxh. fam. & individ	-	-	-	-	-	-	-
Nen-Totali	*Shpenzime korrente*	*164,952.23*	*155,230.00*	*223,659.88*	*250,734.27*	*250,734.27*	*208,150.32*	*(42,583.95)*
230	Kapitale të patrupëzuara	12,614.03	4,911.00					-
231	Kapitale të trupëzuara	59,513.07	125,184.00	19,800.58	56,591.06	56,591.06	33,339.18	(23,251.88)
232	Transferta kapitale	-	-	-				-
Nen -Totali	*Shpenzime kapitale me financim të brendshëm*	72,127.10	130,095.00	19,800.58	56,591.06	56,591.06	33,339.18	(23,251.88)
230	Kapitale të patrupëzuara	-	-	-	-	-	-	-
231	Kapitale të trupëzuara	-	-	-	-	-	-	-
232	Transferta kapitale	-	-	-	-	-	-	-
Nen -Totali	*Shpenzime kapitale me financim të huaj*	-	-	-	-	-	-	-
Totali	*Shpenzime kapitale*	*72,127.10*	*130,095.00*	*19,800.58*	*56,591.06*	*56,591.06*	*33,339.18*	*(23,251.88)*
Totali (korrente + kapitale)		237,079.33	285,325.00	243,460.46	307,325.33	307,325.33	241,489.50	(65,835.83)
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit		Emri	Kryetari Njësisë Vetëqeverisjes Vendore			Emri	TAB.2	
Gentian Keco		Firma	Eduard Duro			Firma		
		Data				Data		

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

ne 000/lekë

Bashkia	Devoll						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2105001
Programi	"SHERBIME SOCIALE"						Kodi i Programit	AC105
Art.	Emërtimi	-1	-2	3	4	5	6	7
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2024	PBA Plan Viti 2025	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2025	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2025	Buxheti Vjetor Plani i periudhës progresive 12- mujore	Fakti i periudhës progresive 12 - mujore	Diferenca
600	Paga	20,074.72	21,562.00	22,608.00	22,608.00	22,608.00	19,569.87	(3,038.13)
601	Sigurime shoqërore	3,353.32	3,601.00	3,775.60	3,775.60	3,775.60	3,274.50	(501.10)
602	Mallra dhe shërbime të tjera	3,915.93	1,909.00	4,411.70	5,489.25	5,489.25	3,327.64	(2,161.61)
603	Subvencione		-					-
604	Transferta korrente të brendshme		-					-
605	Transferta korrente të huaja		-					-
606	Trans për buxh. fam. & individ	2,074.73	2,821.00	1,099.00	3,099.00	3,099.00	1,144.71	(1,954.29)
Nen-Totali	*Shpenzime korrente*	*29,418.70*	*29,893.00*	*31,894.30*	*34,971.85*	*34,971.85*	*27,316.72*	*(7,655.13)*
230	Kapitale të patrupëzuara	-	-	-	-	-	-	-
231	Kapitale të trupëzuara	10,228.98	-	6,346.25	11,595.80	11,595.80	6,581.83	(5,013.97)
232	Transferta kapitale	-	-	-	-	-	-	-
Nen -Totali	*Shpenzime kapitale me financim të brendshëm*	10,228.98	-	6,346.25	11,595.80	11,595.80	6,581.83	(5,013.97)
230	Kapitale të patrupëzuara	-	-	-	-	-	-	-
231	Kapitale të trupëzuara	-	-	-	-	-	-	-
232	Transferta kapitale	-	-	-	-	-	-	-
Nen -Totali	*Shpenzime kapitale me financim të huaj*	-	-	-	-	-	-	-
Totali	*Shpenzime kapitale*	*10,228.98*	-	*6,346.25*	*11,595.80*	*11,595.80*	*6,581.83*	*(5,013.97)*
Totali (korrente + kapitale)		39,647.68	29,893.00	38,240.55	46,567.65	46,567.65	33,898.55	(12,669.10)
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit		Emri	Kryetari Njësisë Vetëqeverisjes Vendore			Emri	TAB.3	
Zerina Sinani		Firma	Eduard Duro			Firma		
		Data				Data		

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

ne 000/lekë

Bashkia	Devoll						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2105001
Programi	"ARSIMI,ARTI,KULTURA DHE SPORTI"						Kodi i Programit	AD105
		-1	-2	3	4	5	6	7
Art.	Emërtimi	Fakti i vitit paraardhës Viti 2024	PBA Plan Viti 2025	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2025	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2025	Buxheti Vjetor Plani i periudhës progresive 12- mujore	Fakti i periudhës progresive 12-mujore	Diferenca
600	Paga	91,235.03	90,536.00	137,438.23	138,543.56	138,543.56	111,338.39	(27,205.17)
601	Sigurime shoqërore	15,128.10	15,119.00	22,560.02	22,769.92	22,769.92	18,431.22	(4,338.70)
602	Mallra dhe shërbime të tjera	22,258.33	17,860.00	31,637.00	38,877.87	38,877.87	28,413.77	(10,464.10)
603	Subvencione		-					-
604	Transferta korrente të brendshme	18,000.00	8,000.00	19,178.10	14,000.00	14,000.00	12,000.00	(2,000.00)
605	Transferta korrente të huaja	-	-					-
606	Trans për buxh. fam. & individ	-	-	-	-	-	-	-
Nen-Totali	*Shpenzime korrente*	*146,621.46*	*131,515.00*	*210,813.35*	*214,191.35*	*214,191.35*	*170,183.38*	*(44,007.97)*
230	Kapitale të patrupëzuara	-	-					-
231	Kapitale të trupëzuara	15,412.79	7,790.00	3,750.00	16,229.98	16,229.98	2,201.61	(14.028.37)
232	Transferta kapitale	-	-					-
Nen -Totali	*Shpenzime kapitale me financim të brendshëm*	15,412.79	7,790.00	3,750.00	16,229.98	16,229.98	2,201.61	(14,028.37)
230	Kapitale të patrupëzuara	-	-	-	-	-	-	-
231	Kapitale të trupëzuara	-	-	-	-	-	-	-
232	Transferta kapitale	-	-	-	-	-	-	-
Nen -Totali	*Shpenzime kapitale me financim të huaj*	-	-	-	-	-	-	-
Totali	*Shpenzime kapitale*	*15,412.79*	*7,790.00*	*3,750.00*	*16,229.98*	*16,229.98*	*2,201.61*	*(14,028.37)*
Totali (korrente + kapitale)		162,034.25	139,305.00	214,563.35	230,421.33	230,421.33	172,384.99	(58,036.34)
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit		Emri	Kryetari Njësisë Vetëqeverisjes Vendore			Emri	TAB.4	
Eliverta Pavliqoti		Firma	Eduard Duro			Firma		
		Data				Data		

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

ne 000/lekë

Bashkia	Devoll						Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2105001
Programi	"BUJQESIA, MJEDISI DHE PYJET"						Kodi i Programit	AE105
Art.	Emërtimi	-1	-2	3	4	5	6	7
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2024	PBA Plan Viti 2025	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2025	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2025	Buxheti Vjetor Plani i periudhës progresive 12- mujore	Fakti i periudhës progresive 12 - mujore	Diferenca
600	Paga	21,702.95	22,296.00	32,327.05	35,659.67	35,659.67	28,846.12	(6,813.55)
601	Sigurime shoqërore	3,624.38	3,723.00	5,398.66	6,062.91	6,062.91	4,841.67	(1,221.24)
602	Mallra dhe shërbime të tjera	10,446.42	11,285.00	31,127.69	35,146.93	35,146.93	10,001.17	(25,145.76)
603	Subvencione	-	-	-				-
604	Transferta korrente të brendshme	-	-	-	-	-	-	-
605	Transferta korrente të huaja	-	-	-	-	-	-	-
606	Trans për buxh. fam. & individ	-	-	-	-	-	-	-
